



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2644/ 7 prot.

Datë 21.10.2024

V E N D I M

Nr. 1468/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.10.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK, si dhe shtim të arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “MC Catering” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-11538-06-28-2024, me objekt: Loti III “Blerje Mish dhe nënproduktet e tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 12,196,604 (dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa TVSH, ose **121,625** (njëqind e njëzet e njëmijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 27.06.2024 është 100.28 lekë, zhvilluar më datë 02.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Argent Daci” P.F me NIPT L01914003T dhe adresë: Rruga “Abdi Bej Toptani”, Godina Nr.21, poshtë kthesës së Valiasit, Kamëz, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, 1001,
Tiranë.

Subjekti i Interesuar: Operatori ekonomik “Nelsa” SHPK me NIPT
J71601012S dhe adresë: Rruga Tiranë - Dajt, Zona
Kadastrale 2460, me Nr. pasurie 199/24 dhe Nr.pasurie
199/32-G3, Lagjja Qesarak, Tiranë.

Operatori ekonomik “MC Catering” SHPK me NIPT
K72218022J dhe adresë: Rruga “Budi”, Pallati
shoqerise “Rogerd”, Njesia Nr. 33, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i
ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285,
datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit
të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021
“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe
funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni
4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.
500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e
Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me
shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e
lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në
përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat
e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë
arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.07.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-11538-06-28-2024, me objekt: Loti III “*Blerje Mish dhe nënproduktet e tij*”, me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 12,196,604 (*dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e katër*) lekë pa TVSH, ose 121,625 (*njëqind e njëzet e njëmijë e gjashtëqind e njëzet e pesë*) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 27.06.2024 është 100.28 lekë, zhvilluar më datë 02.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

II.2. Në datën 02.08.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 19.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “M.C Catering” ShPK	10,303,000	lekë	skualifikuar
2. “Nelsa” ShPK	11,312,000	lekë	kualifikuar
3. “Argent Daci” P.F	11,989,050	lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik më datë 11.09.2024, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 17.09.2024, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër elektronik A/2024/4570, dhe me nr. 2644/2024 prot, datë 17.09.2024, e operatorit ekonomik “*Argent Daci*” P.F. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Nelsa*” SHPK si dhe lenien të skualifikuar të operatorit ekonomik “*MC Catering*” SHPK, me argumentat si mëposhtë vijon:

Në këtë procedurë prokurimi kërkojmë të mbetet i s'kualifikuar shoqëria “MC Catering” shpk dhe kërkojmë të s'kualifikohet operatori ekonomik “Nelsa” shpk, për mospërbushje të

kritereve të kualifikimit konkretisht të pikës 2.1.1 dhe 2.1.6 të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit në DST.

Në Dokumentat Standarte të Tenderit ikapaciteti Teknikë të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit në pikën 2.1 përcaktohet se:

1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes licencë të kategorisë III.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, në emër të tij dhe licencë të kategorisë III.1.B - Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz), të lëshuar nga Qendra kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore). Vendimi mbi kualifikim e operatorit ekonomik më sipër është i pabazuar dhe për rrjedhojë i kundërligjshëm, ardhur si pasojë ose e mos shqyrtimit të dokumentacionit të këtij operatori.

Autoriteti kontraktor në procesverbalin mbi argumentimin dhe miratimin e secifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim të datës 28.06.2024 për objektin e prokurimit “Blerje Mish dhe nënproduktet e tij”, (Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit) mbi argumentimin mbi vendosjen e këtij kriteri ka përcaktuar se: Argumentimi: kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publikë” te ndryshuar nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.538, date 26.05.2009 “Per Licencat dhe Lejet qe Trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit” (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjënës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

Vendimi mbi kualifikim e operatorit Nelsa shpk të përmendur më sipër është i pabazuar dhe për rrjedhojë i kundërligjshëm, ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të këtij legjislacioni. Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjine jo shtazore) sipas objektit të prokurimit, janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës. Referuar procedurë së prokurimit e llojit mallra sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a kontrata e mallrave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, parashikohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të

kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licenca profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi.

Pra, vet autoriteti kontraktor është shprehur qartësisht në arsyetimin për vendosja e kriterit licenca profesionale e operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të jenë në përputhje me mallrat objekt prokurimi.

Sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara kërkojmë s'kualifikimin e operatorit ekonomik NELSA shpk për shkak se kualifikimi i tij është bërë në mospërbushje të kriterit kualifikues mbi licencat dhe për te njejten arsye te qendroje i s'kualifikuar operatori MC CATERING SHPK, ku informacioni mbi licencat i cili është lehtësisht i aksesueshëm në faqet zyrtare <https://qkb.gov.al>.

Në këtë procedurë prokurimi Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik Nelsa Shpk me NIPT J71601012S ku sipas QKB mbi lejet dhe licencat <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/> zotëron licencat e mëposhtme:

- Subjekti është i pajisur me licencën me Kodin II.1.A (1), LN-0431-10-2009, datë 03.02.2020, por kjo licencë është e miratuar për veprimtari specifike prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz bar restorant.

- Subjekti është i pajisur me licencën LN-0366-03-2020, datë 30.03.2020, me Kodin II.1.A (1), por kjo licencë është e miratuar për veprimtari specifike prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz ambalazhim i fruta dhe perimeve.

- Subjekti është i pajisur dhe me licencë të kategorisë II.1.B- shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz).

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor, Komisioni i Vleresimit të Ofertave ka s'kualifikuar operatorin ekonomik MC.Catering nga verifikimi në ëeb-in në qendrën kombëtare të Biznesit, <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/> lidhur me licencat aktive, të kategorisë II.1.A subjekti MC.Cateringë, zotëron licencën e mëposhtme:

- Subjekti është i pajisur me licencën me Kodin II.1.A (1), LN-0241-09-2009, datë 28.07.2023, por kjo licencë është e miratuar për veprimtari specifike prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz catering dhe shërbime catering.

- Subjekti është i pajisur dhe me licencë të kategorisë II.1.B- shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz).

Sa më sipër, kualifikimi i operatorit Nelsa shpk është bërë në kundërshtim me legjislacionin dhe duhej s'kualifikuar nderkohe subjekti MC Catering për të njëjten arsye (mungese licence e pershtatshme) duhet të qendrojë i s'kualifikuar duke qëndruar si ofertë e vetme e kualifikuar në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar në DST, oferta jonë ekonomike.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081/2009 për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë, i ndryshuar, parashikohet se: ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e republikës së shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

Gjithashtu, në Aneksin 3 përmbajtja orinetuese e titullit të licencës dhe kërkesës në pikën 8 Emertimi i veprimtarisë (ve) specifike të licencuara sqarohet se: a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarisë specifike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar të ushtrojë me shume se një veprimtari specifike, ketu vendoset emertimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen. c) Nëse keto shenime kërkojnë me shume se 250 karaktere atëherë vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur.

Në nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 për ushqimin, parashikohet shprehimisht se: faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë.

Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 për ushqimin, parashikohet shprehimisht se: veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.

Në shtojcën e ligjit Nr.10081, datë 23.2.2009 Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë, Fusha II ushqimi dhe shëndetit, parashikohet shprehimisht: Fusha II. Ushqimi dhe shëndeti

4.1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5.2. Licence shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare

6.3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7.4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8.5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9.6. Licence shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10.7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11.8. Licence shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.

Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjetë qendrës kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të 32 përbashkëta, Fusha II ushqimi dhe shëndeti, Kategoria II.1 Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve është kategoria II.1 e shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve, me kodin II.1.A;

b) shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz), me kodin II.1.B;

c) prodhimi primar me shumicë, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posacëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

Në nenin 17, rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.

2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.

3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;

b) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;

c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;

ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimin apo përdorimit të së mirës;

d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;

dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);

e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranondetyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

è) adresën për komunikim;

f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

Referuar sa më sipër, autoriteti kontraktor ka kërkuar se: Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin sipas kriterit të vecantë të kualifikimit sipas pikës 2.1.1 ku parashikohet se: Operatori ekonomik të paraqesë licencën II.1.A. prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve, të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit (nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Kërkesa e e kualifikimit sipas pikes 2.1.1 është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 për prokurimin publik, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Referuar sa më lart, objekti i prokurimit të procedurës objekt-ankimi është Blerje Mish dhe nënproduktet e tij dhe autoriteti kontraktor në kriterin e vecantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin licencë të kategorisë III.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz të lëshuar nga qendra kombëtare e biznesit.

Nga dokumentacioni që kemi përmendur më sipër operatorët ekonomik ekonomik MC.Catering shpk, Nelsa shpk nga kërkimet në ëeb ku gjendet informacioni zyrtar mbi licensat qe disponojnë rezultojnë se disiponojnë licensa me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike ku MC. Catering prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz catering dhe shërbime cateringu, operatori ekonmik, Nelsa shpk diponon licencë për veprimtari specifike prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz bar restaurant dhe licencën për veprimtari specifike prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz ambalazhim i fruta dhe perimeve.

Pra ndërsa objekti i prokurimit është blerje mishi, duke detajuar edhe kodin përkatës për mish në referencë të VKM nr. 457 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit, nuk mund të përzgjidhen fitues subjekte që demonstrojnë aftësi teknike profesionale për ambalazhim fruta perime e restaurant, catering e jo për mish (pra kanë licencë II.A.1, por jo për prodhim, e tregtim mishi)

Cshtë krejt absurde e që: meqë subjekti ka licencë për ambalazhim fruta perimesh apo/dhe restaurant, apo catering atëherë këto janë prova sipas ligjit e logjikës se ka licencë e ka aftësi për të përmbushur një kontratë për furnizim me mish edhe sipas Rekomandimit të përbashkët të APP dhe AKU nr 10181 prot. Datë 19.11.2018 për hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore pa asnjë ekuivok për prokurimet prodhim ose përpunim dhe shpërndarje të ushqimeve për njerëz sanksionohet se OE ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1.A.

Për këto procedura duhet që personeli që do të realizojë procesin duhet të ketë kualifikim të nevojshëm profesional të vërtetuara me dokumentacion.

Theksojmë se gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor do të mbajë në konsideratë faktin se nuk lejohet përdorimi i licenses të një operatori tjetër ekonomik.

Ky rekomandim unifikon standardet për produktet ushqimore dhe është i detyrueshëm për tu përdorur nga AK në procedurat e prokurimit.

Rekomandimet e APP janë të detyrueshme për AK gjatë procedurave të prokurimit publik.

1. Nelsa shpk dhe MC Catering shpk nuk kane kapacitetet për të përmbushur kontratën blerje mish dhe nënproduktet e tij

A. Mungesa e licencës II.1.A për prodhim ose përpunim dhe shpërndarje të ushqimeve shtazore për njerëz, nuk kompensohet edhe pse OE konkurente.

- Kane licencë të kategorisë II.1.B shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz).

- Deklaron kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi pasi pavarësisht këtyre dy kërkesave, OE nuk mund të kualifikohet në këtë procedurë prokurimi, pasi as nuk demonstron e as nuk i ka kapacitetet për të përmbushur kontratën blerje mish e nënproduktet e tij.

B. Licenca II.1.B në referencë të VKM Nr. 538, datë 26.5.2009 për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta në Aneksi I kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet QKL-së Fusha II ushqimi dhe shëndeti detajohet:

- Licenca me kodin II.1.B jepet për shitje në cdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes.

Pra licenca II.1.B jepet për shitje në cdo vend ushtrimi aktiviteti e jo për shpërndarje sikurse jepet licenca II.1.A, që dmth që kualifikimi i subjektit Nelsa e shpallja e mundshme si fitues i tenderit, atëherë dmth që shit/blerja e mishit mes Nelsa dhe Autoritetit Kontraktor kryhet në Qesarat, ku është adresa e vendit të shitjes me shumicë të mishit nga Nelsa, sepse për këtë vend ushtrimi aktiviteti ka licencën e shitjes II.1.B ky subjekt, dhe po e njehta gje vlen edhe për operatorin MC Catering shpk.

Referuar VKM nr 538 datë 26.5.2009 ëpër licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta, përcaktohet se: Kriteret e posacme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë (Në Aneks 1, Fusha II, Kategoria II.1 prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve kreu I, pika 7). Kriteret e posacme Mbi çfarë faktorësh veprimtarie, specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posacme Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posacme përshtatshmëria e njohurive e eksperiencës së personelit a) Drejtuesi teknik (sipas specifikimeve)

A) certifikatë për drejtuesin teknik

B) akte që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës

Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit

- a) standardet tekniko-teknologjike*
- b) higjieno-sanitare (sipas specifikimeve)*

Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve

Sikurse shihet licenca II.1.B parashikon që

Subjekti që e posedon është i certifikuar vetëm për ambientet ku do të shesin mish që e ka importuar apo blerë nga një i tretë. Kjo kategori subjektesh nuk është i certifikuar për

- aftësi të personelit dhe për asnjë manipulim sado të vogël me produktin mish si psh për ta prerë, ndarë mishin nga kockat,

- për shpërndarje të mishit ndaj nuk ka të drejtë as të transportojë mish pasi nuk është e nevojshme sepse subjekti do të kryej vetëm shitje në një vend të caktuar, që përbën veprimtari që mund ta kryej edhe personel pa aftësi profesionale të caktuara.

Kurse licenca II.1.A parashikon që subjekti vec ambienteve edhe personel me dijeni specifike të fushës të certifikuara, ka edhe kapacitete për prodhim ose/dhe përpunim (prerje, ndarje të mishit nga kockat, paketim etj) ose/dhe shpërndarje e transport të mishit.

Kërkesa sipas DST që subjekti të ketë licencë II.1.A nuk është formale por substanciale, që dmth nuk kërkohet thjesht një licencë II.1.A pavarësisht fushës së veprimtarisë për të cilën e ka marrë (catering apo amballazhim fruta perime), pra nuk kërkohet të ketë një licencë II.1.A sa për inventar ose për të treguar se subjekti është më i organizuar se një subjekt tjetër pa këtë nivel licence, por kërkohet licencë II.1.A në fushën prodhim/shpërndarje/furnizim me mish cka dmth që mungesa e kësaj licence (II.1.A) përbën argument jo dekorativ por thelbësor për moskualifikimin e operatorit ekonomik konkurrues.

Nga sa më sipër, është evidente që OE Nelsa dhe OE MC Catering shpk për tu pajisur: Me licencë II.A.1 ndër të tjera kanë demonstruar se plotësojnë kriteret duke demonstruar - përshtatshmërinë e njohurive e ekspertizës së personelit në fushën e cateringut, restorantit e amballazhimit të fruta perimeve por jo të prodhimit e tregtimit të mishit - përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit të cateringut e amballazhimit të fruta perimeve e jo të prodhimit e tregtimit të mishit. Me licencë II.1.B kane demonstruar se plotëson kriteret - jane certifikuar vetëm për ambientet ku do të shesin mish që e ka importuar apo blerë nga një i tretë – Nuk kërkohet dhe nuk jane certifikuar për aftësi të personelit dhe për asnjë manipulim sado të vogël me produktin mish si psh për ta prerë, ndarë mishin nga kockat, - nuk jane te licencuar për shpërndarje të mishit (vetëm shitje në një vend të caktuar) ndaj nuk kane të drejtë as të transportoj mish.

Pra referuar VKM nr 285 datë 19.5.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, AK ka detyrimin që përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale ta konfirmojë përmes licencës profesionale për furnizim të mishit e jo përmes licencës profesionale për

katering, restorant e ambalazhim fruta perimesh apo dhe të të drejtës për të shitur mish në një vend të caktuar.

Pra është evidente që OE Nelsa apo OE MC.CATERING, pavarësisht se mund të posedojnë kontratat e furnizimit me mish të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi nuk kanë kapacitetet për të garantuar përmbushjen e kontratës për të furnizuar sasinë e produktit dhe me një siguri ushqimore të garantuar e certifikuar, pasi licenca II.1.B është për të shitur në një vend të caktuar mishin e siguruar nga kontrata që ka për furnizim me mish me prodhues apo furnizues të autorizuar, e jo për të furnizuar/shprëndarë mish dhe për këtë licencë as nuk ka as nuk i kërkohen aftësi profesionale të stafit. Licencat II.1.A i ka për fushë tjetër veprimtarie e jo për veprimtarinë objekt i këtij prokurimi. Madje me aplikimin e kryer nga keto OE duke paraqit se plotëson kriterin se ka licencë II.1.A për katering, restorant apo për ambalazhim fruta perime për prokurimin me objekt blerje mishi, në fakt po vepron në keqbesim.

Keto OE e dine që nuk i përmbushin kriteret pasi këto licenca për katering e pasticeri nuk vlejnë në prokurimin me objekt blerje mishi sepse pikërisht në 2024 ka marrë vendime skualifikimi në prokurime publike kësajsoj nga AK e tjera (vendime të KKP).

Pra, asnjë nga operatorët nuk plotësojnë dokumentacionin ligjor lidhur me licensimin në përputhje me objektin e kontratës së kësaj procedure prokurimi.

Sa më sipër, objekti i kontratës objekt prokurimi është blerja e mishi, ndërkohë referuar licencave që disponohen nga ana e operatorëve ekonomik, rezultojnë se disponojnë licenca me veprimtari specifike restorant dhe shërbime katering, restorant, ambalazhim i frutave dhe perimeve.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë a-priori dhe në mënyrë sipërfaqësore por të analizojë në themel dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në garë.

Pra, vërtetohet katërcipërisht që operatorët ekonomik nuk e plotësojnë kriterin e kualifikimit, praktikë e cila është ndjekur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e KPP-së 411/2022 datë 29.04.2022 në të cilën kemi qënë subjekt ankimues dhe komisioni në një shqyrtim të drejtë ka vendosur pranimin e ankesës sonë.

Në këtë procedurë për të cilën ankohemi për të njëjtin objekt kriteret kualifikues (mosplotësimin e licensës) dhe nga ana e operatorëve disponohen licensa me veprimtari të ndryshme nga objekti i prokurimit.

Qartësisht, që KVO ka vepruar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST por dhe me legjislacionin e lartpërmendur mbi ushqimin.

Për një informacion mbi licencat dhe sqarim të tyre më datë 24.02.2022 i jemi drejtuar me shkresë Autoritetit kombëtar i Ushqimit ku i kemi kërkuar sqarim lidhur me:

1. Informacion/sqarim lidhur me kufizimet e licencave për ushtrimin e veprimtarisë. A mundet që një subjekt me licence me kodin II.1.A, me përshkrimin e veprimtarisë ikateringë, ibar Restorantë, i ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell) ose furrë buke mund të ushtrojë normalisht aktivitetet përshitjen e mishit të freskët?

Me shkresën nr.411/1 prot datë 04.03.2022, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sqaron se:

1. Në bazë të ligjit nr.10081,datë 23.02.2009 Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.05.2009 Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta e ndryshuar (Aneksi I, Fusha II, Kategoria II.I, Kreu III, në pikat 12,14 të tij), Licencat me kodin II.1.A me aktivitetet Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz restorant, catering, bar-Restorante, furrë buke, prodhime pasticerie etj janë licenca me veprimtari specifike për aktivitetin përkatës si restorant, catering, bar-Restorante, furrë buke etj dhe nuk kanë të bëjnë me tregtimin e mishit të freskët.

Kërkesa e sipërcituar për sqarim dhe informacion mbi licencat e cila do të jetë pjesë e kësaj ankese është bërë nga ana jonë për të njëjtin rast të ngjashme ankimimi ku është vendosur pranimi i ankesës sonë sipas vendimit KPP-së 422/2022, datë 29.04.2022 dhe vendimin 274/2024 datë 12.03.2024.

Sa më sipër, operatorët ekonomik: M.C.Catering shpk, NELSA shpk nuk plotësojnë kriterin 2.1.1 ku kërkohet që operatorët ekonomik të paraqesin licencën: Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme: Kategoria:

II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.nënkategoria:

II.1.A. prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeveë dhe per kete arsye MC Catering duhet te qendroje i s'kualifikuar dhe Nelsa shpk të s'kualifikohet.

Akoma më tej, operatorët ekonomike M.C.Catering shpk, NELSA shpk nuk plotësojnë kriterin 2.1.6 ku në Dokumentat Standarte të Tenderit kërkohet:

1. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, ne zbatim të nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 per ushqimin. Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

A) certifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.

B) Licencen e kategorisë III.1.A.1 dhe licencë të kategorisë III.1.B , për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës a të këtij kriteri.

Operatorëve ekonomik M.C.Catering shpk, NELSA shpk si më sipër kemi argumentuar nuk zotërojnë licencën përkatëse, si rrjedhim nuk kanë paraqitur të saktë dokumentacionin e kërkuar për minimalisht një vendndodhje /stabiliment të pajisur me licencën përkatëse.

Operatorëve ekonomik M.C.Catering shpk, NELSA shpk nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Operatorëve ekonomik M.C.Catering shpk, NELSA shpk nuk plotësojnë kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara.

Kriteret e vecanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëkoha në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të ankesës dhe Komisioni i prokurimit Publik duhet të bëjnë s'kualifikimin e operatorit ekonomik NELSA shpk dhe të mbajnë të s'kualifikuar operatorin ekonomik M.C.Catering shpk,.

Përfundimisht, shoqëria jonë kërkon:

1. S'kualifikimin e operatorëve ekonomik Nelsa shpk dhe mbajtjen të s'kualifikuar operatorin MC.Catering shpk dhe, për mosplotësim dokumentacionit sipas DST-ve.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2644/2 prot., datë 19.09.2024, duke publikuar kriteret e kualifikimit të cilat ankimuesi “Argent Daci” PF pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK dhe “MC Catering” SHPK.

II.7. Me anë të shkresës Nr. 716/39 prot., datë 27.09.2024, protokolluar me tonë me nr. 716/38 prot., datë 26.09.2024, me objekt “Dërgim Vendimi”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF, ku konstatohet, se e ka refuzuar plotësisht ankesën me përmbajtje si më poshtë vijon:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ARGENT DACI” P.F, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertes së operatorit ekonomik “NELSA” SHPK, me arsyen se: “[...] 2.1.1 Operatoret ekonomike, duhet të disponone Licence të kategorise II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushgiveve per njevez. Nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori jeter ekonomik (ne zbatim te rekomandimit te perbashket te APP-së dhe AKU-së të dates 19.11.2018). Dhe pikes 2.1.2 Operatorët ekonomike, duhet të posedojnë të paktën një stabiliment të licensuar për

prodhimin e ushimit. Ky stabiliment duhet te jete brenda bashkise ku do të zbatohet marrëveshja kuader. Objekti mund te jete ne pronesi, gira apo perdorim sipas regullimeve ligjore. Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paragese aktin e pronesise ose kontrate giraje ose perdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkise./...]” KSHA veren se: Ne Dokumentat e Tenderit, “Kriteret e veçanta te kualifikimit”, pika 2.1 “Kapaciteti profesional te operatoreve ekonomike”, nenpika 2.1.1. eshte percaktuar se “Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te parages Licence te kategorise “II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, ne emer te tij dhe Licence te kategorise “II. I.B - Shitje me shumice e ushqimeve me origine shtazore (per njerez)” të leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori jeter ekonomik, sipas Rekomandimit te perbashket të APP-së dhe AKU-së të dates 19.11.2018 nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarres duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore). Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuara ne SPE si dhe atij te dorezuar fizikisht prane autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik “NELSA” shpk eshte i pajisur me licencat si me poshte:

- LN-0366-03-2020 Kodi II.1.A (1) “Prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve”;
- LN-0454-11-2009 Kodi II.1.B “Shitje me shumice e produkteve shtazore dhe nenprodukteve”;

Ne rekomandimin e perbashket te APP-së nr. 10181 prot., dhe AKU-se nr. 8514 prot., date 19.11.2018 me lënde “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, pika III. Hartimi i Kriterëve te Veçanta per Kualifikim, percaktohet se ne hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim, autoriteti kontraktor duhet te mbajë ne konsiderate qe:

a. Ne objektet e prokurimit per prodhim/perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per jerez, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje Licence, kategoria II. I.A. I – “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Per te plotesar ketë kriter per kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese licencen kategoria II. I.A. I – “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez” ne emer te tij pasi licenca duhet ti perkase operatorit ekonomik te interesuar te ofertoje per proceduren e prokurimit te shpallur nga autoriteti kontraktor.

Theksojme se, gjate vleresimit te ofertave autoriteti kontraktor do te mbaje në konsiderate faktin se, nuk lejohet perdorimi i licences te nje operatori tjetër ekonomik.

Ne Dokumentat e Tenderit, “Kriteret e veçanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, nenpika 7 eshte percaktuar se: “Operatori ekonomik duhet te deklaraje sipas tabelës 1 nese është prodhues. Nese operatori ekonomik ishte tregtues duhet te deklaraje sipas tabelës 2,

kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklaramentit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Tabela 2. Forma e deklaramentit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues si I autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE dhe atij të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik "NELSA" shpk ka paraqitur kontratat e furnizimit si më poshtë:

1. Kontrata furnizimi me Nr.6683 Kol datë 14.12.2019 lidhur ndërmjet shoqërisë "NELSA" shpk dhe shoqërisë "KAZAZI-MEAT" shpk ku kjo e fundit merr përsipër të furnizojë shoqërinë "NELSA" shpk me "Mish të freskët" për realizimin e kontratave me Autoritetin kontraktues, në rastin e shpalljes fitues të procedurës objekt prokurimi.

- Shoqëria "KAZAZI-MEAT" shpk ndër të tjera disponon Licencën II.I.A (1) Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Përpunim mishi);

2. Kontrata furnizimi me datë 01.08.2024 lidhur ndërmjet shoqërisë "NELSA" shpk dhe shoqërisë "Driza" shpk ku kjo e fundit merr përsipër të furnizojë shoqërinë "NELSA" shpk me "Mish pulë" për realizimin e kontratave me Autoritetin Kontraktor sipas nevojave dhe kërkesave të shoqërisë "Nelsa" shpk.

- Shoqëria "Driza" shpk disponon licencë II..A (1) Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (thertore);

Referuar rekomandimit të APP-se nr. 6732 prot., datë 21.10.2020 "Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime" pika II "Rekomandime për procedura prokurimi me objekte të posaçme", pika 2, germa b) citohet: b) "Autoritetet kontraktore nuk përcakton licencën e nevojshme që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës. Konkretisht, në kriteret e veçanta të kualifikimit, në disa raste AK kërkojnë licencë të leshuar nga QKL, por pa caktuar kodin përkatës, në kundërshtim me parashikimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve kualifikuesë. Në rastet e tjera, AK kërkojnë licencë që tejkalojnë objektin e kontratës. Konkretisht, kërkojnë licencë kodit II.I.C për produktet ushqimore që kërkojnë të furnizohen, ndërkohe që kjo licencë është për prodhimin primar me shumicë, duke kufizuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që edhe pse nuk janë prodhues primar të produkteve, i tregtojnë këto produkte, duke plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme ligjore dhe të përcaktuara nga AK.

Në disa procedura prokurimi, për produktet ushqimore të kërkuara, si mish dhe fruta perime, AK kërkojnë nga operatorët ekonomikë të kenë në pronësi apo në përdorim thertore dhe serë. Nderkohë, produktet e kërkuara mund të sigurohen edhe nëpërmjet kontratave të furnizimit me subjekte të tjera që operojnë në fushën e tregtimit të këtyre produkteve, dhe që jo domosdoshmërisht janë thertore apo kanë sera, por produktet e tyre i tregtonë në përputhje

me kërkesat ligjore”. Në Ligjin nr. 10081, date 23.2.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu V “Procedurat e Licencimit/Autorizimit/Lejimit nga apo Npërmjet Qkb-së”, Seksioni 2 “Kërkesa, Shqyrtimi dhe Vendimmarrja”, Neni 17 Rregulla te perbashkëta per kërkesen per licence/autorizim/leje per te gjitha grupet”, pikat 1,2,3 percaktohet se:

1. Kërkesa per licence/autorizim/leje apo nenkategori te tyre paraqitet ne QKB, sipas procedurave te nenit 34 të ketij ligji.

2. Kërkesa perbehet nga formulari tip i plotesuar dhe dokumentet shoqeruese perkatese.

3. Formulari tip permban, te pakten, këto te dhëna:

1. emertimin e kategorise /nënkategorise;

2. llojin e veprimtarise, veprimet apo te se mires publike e të perdorimit te saj;

3. te dhenat per identifikimin e kerkuesit dhe te personit qe paraqet kerkesën; ç) vendin apo vendet e ushtrimit te veprimtarise, te kryerjes se veprimet apo perdorimit te se mires;

4. te dhena te tjera specifike, sipas kategorise /nenkategorise;

dh) deklaraten e kerkuesit, qe verteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i permbush ato (për kriteret, permbushja e te cilave vetedeklarohet);

e) deklaraten per vertetesine e dokumenteve shoqeruese dhe/ose qe i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i permbushe ato;

ë) adresën per komunikim;

f) listen e dokumenteve shoqeruese që duhet paraqitur.

Ne Dokumentat e Tenderit, “Kriteret e veçanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, nenpika 6 eshte percaktuar se: “Operatori ekonomik duhet te disponoje minimalisht 1 (nje) stabiliment, ne zbatim te nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”. Për te provuar këte kriter duhet te paragese dokumentet:

1. Certificate proniesie ose kontrate noteriale qiraje/perdorimi te vlefshme, per stabilimentin.

2. Licencen e kategorise “II.1.A. I dhe Licence te kategorise “II. I.B, per stabilimentin qe ka paraqitur dokumentet sipas gërmes “a” te ketij kriteri”.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE dhe atij te dorezuar prane autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik “NELSA” shpk ka paraqitur:

Kontrate Huapërdore me nr. 19 Kol., nr. 41 Rep., date 11.01.2021, me afat te papercaktuar, për 3 (tri) njesi me siperfaqe totale 545m2, ndodhur ne Dajt, Zona Kadastrale 2460, shoqëruar me Akt Miratim Hijgeno-Sanitar nr. 1883 dhe nr. 1884, date 11.12.2015;

Kontrate Huapërdorje me nr. 124 Kol., nr. 315 Rep., date 08.03.2022, me afat te papercaktuar, per nje njesi garash me siperfaqe 96 m2, ndodhur ne Dajt, Zona Kadastrale 2460;

Sa me siper, referuar frymes se legjislacionit per prokurimin publik, vendosja e kriterëve te veçanta per kualifikim ka si synim kryesor qe t'i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatorive ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vërtetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmerine, pervoën e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne varsi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e veçanta per kualifikim, te cilat janë te detyrueshme per t'u permbushur nga operatorët ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Ne çdo rast kriteret duhet te jene ne perpjestim me objektin e kontrates ge prokurohet, duke i'u referuar frymes se LPP per stimulim te pjesemarries se biznesit te vogel dhe te mesem, mosdiskriminim dhe trajtim te barabarte giate vleresimit. Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me këto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme. Autoriteti kontraktor verifikon dhe verison ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetim ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per t'u permbushur nga te githe ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Autoriteti kontraktor do te konsideroje nje oferte te vlefshme, vetm nese ajo eshte ne perputhje me te githa kerkesat dhe specififikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.

Ne rastin konkret nga verifikimi i kryer, KSHA konstaton se operatori ekonomik "NELSA" shpk, ne permbushje te pikes 2.1.1 te Kriteve te veçanta te kualifikimit, ka paraqitur Licencat perkatese, sipas kerkeses se percaktuar ne DT si dhe ne perputhje me legjislacionin perkates. Licencat "LN-0366-03-2020 Kodi II.1.A (1) "Prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve" dhe "LN-0454-11-2009 Kodi II. 1.B "Shitje me shumice e produkteve shtazore dhe nenprodukteve" rezultojne ne emer te shoqerise "NELSA" shpk, kjo ne perputhje me rekomandimin e perbashket te APP-se nr. 10181 prot., dhe AKU-se nr. 8514 prot., date 19.11.2018. Gjithashtu, KSHA konstaton se pika 2.3 e Kapacitetit teknik, nenpika 7 eshte permbushur prej operatorit ekonomik "NELSA" shpk, pasi ky i fundit, duke mos qene prodhues, ka patur detyrimin te deklaroj sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit te lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, per artikujt objekt prokurimi dhe ne permbushje te kesaj kerkese eshte dorezuar tabela 2 e plotesuar me furnitoret shoqeruar edhe me kontratat furnizimit perkatese. Akoma me tej, KSHA konstaton se operatorit ekonomik "NELSA" shpk ka paraqitur Kontratave e Huaperdorjes per pasuri te paluajtshme, te cilat i merr ne perdorim si ambiente ne funksion te ushtrimit te aktivitetit te tij dhe, referuar pikes 3/ç) te nenit 17, Ligin nr. 10081, date 23.2.2009 "Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shiperise", me dokumentacionin e dorezuar, ishte pajisur edhe me licencat e sipercituara IN-0366-03-2020 Kodi II.1.A (1) "Prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve" dhe "IN-0454-11-2009 Kodi II. 1.B "Shitje me shumice e produkteve shtazore dhe nenprodukteve". KSHA sjell ne vemendje edhe rekomandimin e APP-se nr. 6732 prot., date 21.10.2020, mbi sigurimin/zoterimin e stabilimenteve duke i'u referuar kontratave të furnizimit, konkretisht ne disa procedura prokurimi, per produktet ushqimore te kerkuara, si mish dhe fruta perime, AK kerkojnë nga operatorit ekonomike te kene ne pronesi apo ne perdorim thertore dhe sere. Nderkoh, produktet e kerkuara mund te sigurohen edhe nepermjet kontratave te furnizimit me subjekte te tjera qe operojne ne fushen e tregtimit te ketyre produkteve, dhe qe jo domosdoshmerisht jane thertore apo kane sera, por produktet e tyre i tregtojne në perputhje me kerkesat ligjore. Ne rastin e procedures ne fjale te prokurimit, rekomandimi i sipercituar i APP-se eshte marre ne konsiderate nga autoriteti

kontraktor, duke u pasqyruar si kriter ne Dokumentat e Tenderit, pika 2.3. 7 e Kapacitetit teknik. Sa me siper, referuar dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), nga operatori ekonomik "NELSA" shpk, si dhe dokumentacionit te dorezuar prej ketij te fundit prane autoritetit kontraktor, sipas percaktimeve të pikes 6 te nenit 26 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit", te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021, "Per miratimin e rregullave te prokurimit public" i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses gjykon se operatori ekonomik "NELSA" shpk, ka paraqitur dokumentacionin e rregullt, duke permbushur kriteret e percaktuara ne ne Dokumentat e Tenderit, pikat 2.1.1; 2.3.6; dhe 2.3.7; objekt ankimimi.

Sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

II.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "ARGENT DACI" P.F, mbi ofertën ekonomike te paraqitur nga operatori ekonomik "M.C.Catering" shpk, KSHA gjykon se, fati i kesaj shoqerie eshte percaktuar tashme prej vendimit te KVO-se date 19.08.2024, ku shoqëria "M.C.Catering" shpk rezulton e skualifikuar nga kjo procedure prokurimi, e për rrjedhoje pa asnje ndikim ne interesat e ankimuesit. Per me teper, nga verifikimi i informacionit gjate periudhes se afatit te ankimimit, nuk rezulton qe ky operator ekonomik te jete ankimuar ne lidhje me kete procedure prokurimi.

Rjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik "ARGENT DACI" sh.p.k. mbi shoqerine "M.C.Catering" sh.p.k. nuk do te merret ne shqyrtim.

Për këto arsye

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin public", i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, zyrtari i ngarkuar per shqyrtimin e ankesës,

Vendosen

1. Refuzimin e ankeses te paraqitur nga operatori ekonomik "ARGENT DACI" P.F.
2. Personi pergjegjës per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, brenda dites se nesërme te punes nga marrja e ketij vendimi.
3. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se nesërme te punes nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.
4. Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit te Organit Qëndror Blerës.

II.7. Nëpërmjetë shkresës së datës 04.10.2024, protokolluar me tonë me nr. 2644/4 prot., datë 08.10.2024, me objekt "Në vijim të ankkmit për procedurën me objekt Loti 3 Blerje mish dhe nënproduktet e tij", operatori ekonomik ankimues "Argent Daci ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, argumenta shtesë në lidhje me ankesën nr. 2644/2024 prot, datë 17.09.2024.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “*Nelsa*” SHPK, me argumentin se: “*Sa më sipër, operatori ekonomik NELSA shpk nuk plotësojnë kriterin 2.1.1 ku kërkohet që operatorët ekonomik të paraqesin licencën: Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme: Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.nënkategoria: II.1.A. prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeveë dhe per kete arsye Nelsa shpk të s’kualifikohet. Akoma më tej, operatori ekonomik NELSA shpk nuk plotësojnë kriterin 2.1.6 ku në Dokumentat Standarte të Tenderit kërkohet: 1. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, ne zbatim të nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 per ushqimin. Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet: A) certifikatë pronsie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin. B) Licencen e kategorisë III.1.A.1 dhe licencë të kategorisë III.1.B , për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës a të këtij kriteri...*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.1 “*Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë*”, dhe pika 2.3.6 “*Kapaciteti teknik*” përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.1. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, në emër të tij dhe Licencë të kategorisë “II.1.B - Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).*

2.3.6. *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, ne zbatim të nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”. Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:*

- a) *Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.*
- b) *Licencën e kategorisë “II.1.A.1 dhe Licencë të kategorisë “II.1.B , për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri.*

Ne rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këto nen do të referohen prane AKU për ndjekjen e procedurave perkatëse administrative sipas nenin 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Vetdeklarimi.
- Deklaratë prodhuesi distributori loti 3 OPB, ku shoqëria Nelsa shpk deklaron se për procedurën objekt prokurimi shoqëria Nelsa shpk disponon kontratat e furnizimit.
- Deklaratë stabilimenti ku shoqëria deklaron se disponon ambiente/stabilimente për produkte shtazore dhe për produkte ushqimore dhe fruta perime, në përdorim me vendodhje Lagjia Qesarak, Dajt, Tiranë.
- Kontratë Huapërdorje me Nr. 41 Rep, dhe Nr. 17 Kol, datë 11.01.2021 me palë huadhënëse z. N. B dhe huamarrëse shoqëria Nelsa shpk, pa afat të caktuar, për ambientin garazh 234 m², njësi 208 m² dhe njësi 103 m² me vendndodhje në Dajt.
- Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-0366-03-2020 dhe me miratim kërkesë me Nr. 529/2 prot, datë 27.03.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Ambalazhim i frutave dhe perimeve).
- Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-0459-04-2020 dhe me miratim kërkesë me Nr. 3373/2 prot, datë 04.11.2009, me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Shitje me shumicë e produkteve shtazore dhe të nënprodukteve. Shitje me shumicë e produkteve të bulmetit.

III.1.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Në nenin 40 pika 5 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.6. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orinetuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emertimi i veprimtarisë(ve) specifike të licencuara sqarohet se: *a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarisë specifike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar të ushtroje me shume se një veprimtari specifike, ketu vendoset emertimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen. c) Nëse keto shenime kërkojnë me shume se 250 karaktere atëherë vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr..... ”*

III.1.7. Në nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes” është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë”.

III.1.8. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.*

III.1.9. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht:

Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare

6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.

III.1.10. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjetë qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III.1.11. Në nenin 17, “Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.
2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.
3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:
 - a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;
 - b) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;
 - c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;
 - ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimin apo përdorimit të së mirës;
 - d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;
 - dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);
 - e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;
 - ë) adresën për komunikim;
 - f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.
4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.
5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

III.1.12. Në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.
2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:
 - a) emrin dhe stemën e QKL-së;
 - b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;
 - c) të dhënat për identifikimin e titullarit;
 - ç) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;
 - d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);
 - dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimin apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka);
 - e) afatin e vlefshmërisë;

ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;
f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;
g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

III.1.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.* Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar se: *1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, në emër të tij dhe Licencë të kategorisë “II.1.B - Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore)."* Referuar proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor për kriterin e mësipërm ka arsyetuar se: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik*

duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjens dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.. Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se objekti i prokurimit të procedurës objekt-ankimi është **Blerje Mish dhe nënproduktet e tij**, dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit në pikën 2.2.1 ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1.B - Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” dhe për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet: a) Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin, dhe b) Licencën e kategorisë “II.1.A.1 dhe Licencë të kategorisë “II.1.B, për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri. Akoma më tej, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me ligjin, do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 te ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik ka dorëzuar **1- Licencë e kategorisë II.1.A (1) LN-0366-03-2020 dhe me miratim kërkesë me Nr. 529/2 prot, datë 27.03.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Ambalazhim i frutave dhe perimeve), dhe 2- Licencë me Kodin II.1.B (1) LN-0454-04-2020 dhe me miratim kërkesë me Nr. 3373/2 prot, datë 04.11.2009, me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Shitje me shumicë e produkteve shtazore dhe të nënprodukteve. Shitje me shumicë e produkteve të bulmetit.**

Kështu, në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. **Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës**”. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar se kërkesat e vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit duhet të jenë në proporcion me objektin e kontratës. Nga ana tjetër, vetë autoriteti kontraktor në arsyetimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit në lidhje me këtë kriter ka arsyetuar se **kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore**. Në rastin konkret, objekti i kontratës objekt prokurimi është blerja e mishit dhe nënprodukteve të tij, ndërkohë referuar licencave të dorëzuara në SPE nga ana e operatorit ekonomik, rezulton se ky i fundit disponon dy lienca me veprimtari specifike **Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Ambalazhim i frutave dhe perimeve) dhe Shitje me shumicë e produkteve shtazore dhe të nënprodukteve. Shitje me shumicë e produkteve të bulmetit.**

Me Vendimin nr. 457 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” rezulton se shërbimi ambalazhim i frutave dhe perimeve është në kategorinë e kodeve të veprimtarive të **Produkteve bujqësore, blegtorale, peshkimi, pylltarie dhe të lidhura me to: 03000000-1**, ndërkohë kodet e përzgjedhura nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit janë: Fasule - 03221210-1; Oriz - 03211300-6; Bukë - 15811100-7; Mollë - 03222321-9; Kos - 15551300-8; Qumësht - 15511000-3; Djathë i freskët - 15542000-9; Vezë - 03142500-3. Pra kode që hynë në kategorinë e Produkteve ushqimore, pije, duhan dhe lidhura me to kategori në të cilën bën pjesë edhe objekti i lotit të III objekt shqyrtimi mish dhe nënproduktet e tij, por kodet Fasule - 03221210-1; Oriz - 03211300-6; Mollë - 03222321-9; hynë në kategorinë e Produkteve bujqësore, blegtorale, peshkimi, pylltarie dhe të lidhura me to. Gjithashtu, në ligjin nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Aneksin 3 “Përmbajtja orinetuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emërtimi i veprimtarisë(-ve) specifike të licencuara sqarohet se: a) Këtu vendoset emërtimi i veprimtarisë specifike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar ëe ushtrojë më shumë se një veprimtari specifike, këtu vendosen emërtimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen. c) Nëse këto shënime kërkojnë më shumë se 250 karaktere atëherë vihet shënimi: Për llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....”. Komisioni Prokurimit Publik në një procedurë të ngjashme ka patur korespondencë me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, i cili me shkresën nr. 1139/1 prot., datë 01.03.2024 protokolluar me tonën me nr. 113/10 prot., datë 04.03.20234, ka njoftuar KPP si më poshtë: “- Referuar përshkrimin të veprimtarisë që i përket veprimtarisë me Kod II.I.B: “Shtetje me shumicë e ushqimeve me 35 origjinë shtazore (për njerëz)”, subjekti ka detyrim ligjor licencimin, pra nëse kryen vetëm aktivitet importuesi tregtues për produktet ushqimore me origjinë shtazore. - Nëse subjekti kryen aktivitet prodhuesi përpunues të mishit dhe produkteve me bazë mishi”, duhet të pajiset me licencë me kod veprimtarie II.I.A 1 me aktivitet “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike: “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (mish dhe produkte me bazë mishi)”, gjithashtu, sqarojmë se në këtë licencë i ka të përfshira importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar”. Sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik është i licencuar për veprimtari të ndryshme nga ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Licencës së kategorisë II.1.A.1 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga verifikimi i tyre rezulton, se në Licencat II.1.A. me të cilat është pajisur ky operator ekonomik, veprimtarinë specifike të përshkruar në licencë e ka për **Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Ambalazhim i frutave dhe perimeve)**, ndërkohë që objekti i prokurimit është mish dhe nënprodukte të tij. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesve dhe përzgjedhjen e tyre nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke kualifikuar në këtë mënyrë operatorë ekonomikë të cilët nuk disponojnë dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor. Gjykojmë, se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon

kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me licencat e kërkuara. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Sqarojmë se, kriteri për licencat duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjitha elementet e përcaktuara nga ligjvënësi si dhe të kërkuara dhe përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi, referuar mangësive të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të vërtetohet disponimi i licencës së kategorisë II.A.1, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave, që përmban licenca, si dhe të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Ndërkohë KPP gjykon, se fakti që subjekti ka dorëzuar licenca të kategorisë II.1.A, jo domosdoshmërisht do të thotë që është përmbushur kriteri, pasi veprimtaria specifike ashtu sikurse është përcaktuar dhe në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: 1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj. 2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna ndër të tjera **ç) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj.** Nga sa më sipër KPP gjykon, se licensimi i subjekteve kryhet për një veprimtari të caktuar të prodhimit, përpunimit, paketimit dhe shpërndarjes së ushqimeve. Në këtë kuptim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik “Nelsa” SHPK qëndron, pasi ky i fundit nuk arrin të provojë se disponon licenca II.1.A me fushë veprimtarie specifike prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje të ushqimeve për njerëz, (mish dhe nënproduktet e tij).

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente, pasi ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorin ekonomik “Nelsa” SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatorin ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”*, KPP gjykon se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK duhet të kishte dorëzuar licencat e kategorisë II.1.A për sa i përket veprimtarisë specifike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ku është cituar se **operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve/furnizimeve, objekt i kontratës**. Në këtë kuptim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik “Nelsa” SHPK qëndron, pasi ky operator nuk arrin të provojë se disponon licencë II.1.A me fushë veprimtarie specifike prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje të ushqimeve për njerëz, (mish dhe produkte me bazë mishi), informacion për të cilin edhe organi kompetent AKU ka sqaruar KPP përmes shkresës me nr. 1139/1 prot., datë 01.03.2024, protokolluar me tonën me nr.113/10 prot., datë 04.03.2024. KPP sjell gjithashtu në vëmendje, se qëndrueshmëria në vendimmarrje është një nga detyrimet mbi bazën e të cilit mbështetet dhe veprimtaria e vetë Komisionit dhe bazuar mbi këtë fakt të njëjtin qëndrim KPP ka mbajtur edhe në vendimin nr. 411/2022, datë 29.04.2022 dhe vendimin nr. 274/2024, datë 12.03.2024.

III.1.15. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF mbi skualifikimin e shoqërisë “*Nelsa*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “*Nelsa*” SHPK do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF mbi shoqërinë “*MC Catering*” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 19.08.2024, ku kjo shoqëri rezulton e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që ky operator ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik “*Argent Daci*” PF mbi shoqërinë “*MC Catering*” SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Argent Daci*” PF për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-11538-06-28-2024, me objekt: Loti III “*Blerje Mish dhe nënproduktet e tij*”, me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj,, me fond limit të marrëveshjes kuadër:

12,196,604 (dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa TVSH, ose 121,625 (njëqind e njëzet e njëmijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 27.06.2024 është 100.28 lekë, zhvilluar më datë 02.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Argent Daci” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

